



Republika e Kosovës - Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Raport Vjetor

Janar – Dhjetor 2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP

Prishtinë, Janar 2015

Rruga Luan Haradinaj "Ndërtesa e ish Bankës së Lubjanës kati –I-, 10000 Prishtinë

info@pzap-ks.org, www.pzap-ks.org 038/211-242

Përmbajtja

| | | |
|-----|---|----|
| 1. | RRETH PANELITZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP) | 1 |
| 1.1 | Pjesa e Përgjithshme..... | 1 |
| 2. | STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE BURIMET NJERËZORE TË PZAP-IT | 2 |
| 2.1 | Përbërja e PZAP-it | 3 |
| 2.2 | FUNKSIONET, PËRGJEGJËSIT DHE PËRBËRJA E SEKRETARIATIT TË PZAP-it..... | 3 |
| | Organogrami i PZAP-it..... | 5 |
| 3. | Aktivitetet ePZAP-it dhe të Sekretariatit..... | 6 |
| 4. | AKT EMËRIMET E SHËRBYESVE CIVIL DHE VLERËSIMET E PUNËSPËR PERSONELIN E SEKRETARIATIT TË PZAP-IT | 6 |
| 4.1 | Rekrutimi i Stafit jo permanent gjatë procesit zgjedhor 2014..... | 7 |
| 4.2 | Zyraligjore..... | 7 |
| 4.3 | PËRKTHIMI I DOKUMENTEVE DHE QASJA NË INFORMATAT ZYRTARE | 8 |
| 4.4 | FAQJA ZYRTARE NË INTERNET | 8 |
| 5. | KOMISIONET E PËRHERSHME TËPZAP-it..... | 9 |
| 5.1 | Komisionet e përkohshme të PZAP-it | 10 |
| 6. | PUNËTORITË E PZAP-IT TË MBAJTURA NË VITIN 2014..... | 10 |
| 6.1 | Pjesëmarrja e anëtareve të PZAP-it dhe personelit të sekretariatit të PZAP-it në vizita dhe grupe punuese në vend dhe jashtë vendit | 11 |
| 6.2 | Vizitanë Maqedoni | 11 |
| 7. | NDARJET BUXHETORE | 11 |
| 7.1 | BUXHETI I PLANIFIKUAR PËR VITIN - 2014 | 12 |
| | Struktura e buxhetit për vitin 2014..... | 12 |
| 7.2 | BUXHETI I SHPENZUAR PER VITIN 2014 | 13 |
| 7.3 | PJESA PËRMBYLLSE E RAPORTIT TË SHPENZIMEVE | 16 |
| 7.4 | TE HYRAT E PZAP-it | 16 |
| 8. | BASHKËPUNIMI I PZAP-IT ME INSTITUCIONET INSTITUCIONET QË NDËRLIDHEN ME PROCES TË ZGJEDHJEVE..... | 20 |
| 8.1 | Bashkëpunimi i PZAP-it me Komisionin Qendror Zgjedhor - KQZ..... | 20 |
| 8.2 | Bashkëpunim i PZAP-it, me Policinë e Kosovës..... | 21 |
| 8.3 | Bashkëpunimi i PZAP-it, me Gjykatën Supreme të Kosovës | 21 |
| 8.4 | Bashkëpunimi i PZAP-it, me Gjykatat Themelore në Kosovës | 21 |

| | | |
|-----|--|----|
| 8.5 | Bashkëpunimi i PZAP-it, me Komisionin e Pavarur të Mediave (KPM) | 22 |
| 8.6 | Bashkëpunimi i PZAP-it, me Prokurorinë e Shtetit | 22 |
| 8.7 | Bashkëpunimi i PZAP-it, me Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian – OSBE | 22 |
| 8.8 | Bashkëpunim i PZAP-it, me IFES-in | 24 |
| 9. | PËRMBLEDHJEEKZEKUTIVEDHESTATISTIKAPËR ZGJEDHJETE PARAKOHSHME PARLAMENTARE TË VITIT 2014..... | 25 |
| 10. | NATYRA E ANKESAVE TË PARAQITURA NË PZAP GJATË PROCESIT TË ZGJEDHJEVE PARAKOHSHME PARLAMENTARETË VITIT 2014 | 28 |
| 11. | RASTET E DËRGUARA NË PROKURORINË E SHTETIT | 36 |
| 12. | PADITË E PARAQITURA NDAJ VENDIMEVE TË PZAP-IT NË GJYKATËN SUPREME | 37 |
| 13. | ANKESAT E PRANUARA NË PZAP NGA VOTUESIT JASHTË KOSOVËS..... | 38 |
| 14. | MEMORANDUMI I BASHKËPUNIMIT | 39 |

Lista e Shkurtesave

PZAP – Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

KQZ – Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

KGJK – Këshilli Gjyqësor i Kosoveës

KPK – Këshilli Prokurorial i Kosovës

KPM – Komisioni i Pavarur për Media

KRPP – Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik

PK – Policia e Kosoves

OSCE – Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim Evropjan

IFES – Fondacioni Ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore

MEF – Ministria e Eknomisë dhe Financave

SIMFK – Sistemi Informativ për Menaxhmin e Financave te Kosovës

SP - Subjekete Politike

KP – Kandidat i Pavarur

1. RRETH PANELITZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP)

1.1 Pjesa e Përgjithshme

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), si institucion i pavarur në kryerjen e funksioneve të tij i cili është kompetent për të vendosur nëlidhje me ankesat dhe apelet që parashtrihen në PZAP nga palët e interesuara e që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor siç është përcaktuar me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) dhe Rregullat Zgjedhore.

PZAP-i, me përkushtim, krijon politika dhe strategji që t'i siguron të gjitha palët e involvuara në procesin zgjedhor të jenë të barabarta në procedurë, pavarësisht përkatësisë së tyre etnike apo fetare.

Në kuadër të bazës ligjore përgjegjëse të tij PZAP-i, ushtron funksionin sipas nenit 115 të Ligjit Nr.03/L-256 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-073 për rZgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP) dhe Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën Kosovës (Ligjinr. 03 /L-072).

PZAP-i, gjatë vitit 2014 ka demonstruar fuqinë e plotë të përballjes me mijra ankesa për procesin zgjedhor të Zgjedhjeve Parlamentare 2014, i cili ka arritur që me sukses të vendos për të gjitha ankesat dhe apelet e parashtruara nga palët lidhur me procesin zgjedhor. Kjo është arritur përmes prioriteteve të përcaktuara për zbatimin e ligjit dhe promovimin e transparencës dhe forcimin e integritetit e institucional.

Raporti vjetor për periudhën 01 janar – 31 dhjetor 2014, pasqyron në detaje të gjitha aktivitetet dhe iniciativat e ndërmarra nga PZAP-i, për këtë periudhë kohore.

Për më tej gjatë këtij procesi PZAP-i, ka vërejtur se ka mangësi të kornizës ligjore që ndërlidhen me misionin e PZAP-it, e cila mungës ligjore ka penguar tërthorazi edhe misionin e PZAP-it gjatë realizimit të objektivave të tij. Poashtu raporti përfshin edhe rekomandimet e mëtejshme që reflektojnë kontekstin në të cilin u adresohen institucioneve të Kosovës për masa plotësuese.

Misioni i PZAP-it, është i përqendruar në mbrojtjen e të drejtave zgjedhore, respektivisht krijimin e ambientit për Zgjedhjeve të lira, të drejta dhe demokratike sipas standardeve ndërkombëtare, si për nivelin qendror ashtu edhe për nivelin lokal. Poashtu ka për qëllim zbulimin, hetimin dhe vendosjen e pretendimeve ankimore që ndërlidhen me procesin zgjedhor.

Në vitin 2014 PZAP-i, ka bërë përpjekje për parandalimin e parregullsive të mundshme zgjedhore, duke e sensibilizuar opinionin publik me të drejtat për ankesë dhe gjokat që shqiptohen në rast të shkeljes së LZP-së dhe Rregullave Zgjedhore, e cila çështje ka ndikuar pozitivisht në opinion me

çkashihet edhe te plotësimi i ankesave nga palët e intersuar dhe te përmirësim i shkeljeve te bëra nga subjektet politike.

2. STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE BURIMET NJERËZORE TË PZAP-IT

Struktura organizative e brendshme e PZAP-it, është e rregulluar me Ligjin Nr. 03/L-256, për Ndryshim dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, ne te cilat përcaktohet mënyra kryerjve te punëve si dhe përgjigjësia institucionale.

PZAP-i, përbëhet nga Anëtarët e Panelit dhe nga Sekretariati i tij.

Anëtarët e panelit të PZAP-it, janë 10 gjyqtarë nga gjykata të ndryshme ne Kosovë, kanë mandatë 4 vjeçar dhe emërohen si anëtarë te PZAP-it, me vendim nga Kryetari i Gjykatës Supreme.

Sekretariati i PZAP-it, përbëhet nga kryesuesi i Sekretariatit, Zyra e Finacave dhe nga Zyra Ligjore.

Me vendimin e Kryetarit te Gjykatës Agj.nr. 685/2010 të datës 08.11.2010, janë emëruanëtarët e PZAP-it, duke përfshirë këtu edhe kryesuesin, me një mandat katër vjeçar, si më poshtë:

1. Shukri Sylejmani, Gjyqtar i Gjykatës Supreme të Kosovës, Kryesuesi PZAP- it;
2. Muharrem Shala, Gjyqtar i Gjykatës së Apelit –Prishtinë, anëtarë;
3. Ymer Hoxha, Kryetar i Gjykatës së Themelore – Prizren, anëtarë;
4. Hasan Shala, Gjyqtar i Gjykatës së Apelit –Prishtinë, anëtarë;
5. Xhevdet Abazi, Gjyqtar i Gjykatës së Apelit –Prishtinë, anëtarë;
6. Ferit Osmani, Gjyqtar i Gjykatës së Apelit –Prishtinë, anëtarë;
7. Nehat Idrizi, Gjyqtar i Gjykatës së Themelore – Prishtinë, anëtarë;
8. Rafet Haxhaj, Gjyqtar i Gjykatës së Themelore – Prishtinë, anëtarë,
9. Muhamet Rexha, Gjyqtar i Gjykatës së Apelit –Prishtinë, anëtarë dhe
10. Nenad Laziq, Gjyqtari i Gjykatës së Apelit –Prishtinë, anëtarë.

Siç shihet nga vendimi i lartpërmendur i Gjykatës Supreme anëtarët e panelit kanë pas mandat si anëtarë te panelit deri me dt.08.11.2014, duke e përjashtuar në këtë rast gjyqtarin Nenad Laziq, gjyqtar i Gjykates se Apelit nga se është emëruar në PZAP, me vendimin e kryetarit te Gjykatës Supreme Agj.nr.241/2012 datë 09.11.2012, i cili ka mandat deri më 09.11.2016, pas dorëheqjes se gjyqtarit Vlastimir Dimiq, që ishte emëruar nga Kryetari i Gjykatës Supreme si antëtarë i panelit, më datë 02.11.2012 i është aprovuar kërkesa për dorëheqje si gjyqtarë i Republikës së Kosovës nga KGJK-ja po ashtu ju ka miratuar edhe kërkesa për dorëheqje si anëtarë i PZAP-it.

Në kuadër të bazës ligjore siç përcaktohet me Ligjin Nr. 03/L-256, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe kompetencave që parashihen, Kryetari i Gjykatës Supreme te Republikës së Kosovës me vendimin Agj.nr. 410/2014 të datës 31.10.2014, ka bërë emërimin 5 anëtarëve te ri dhe rrimërimin e 4 anëtarëve te PZAP-it duke përfshirë edhe kryesuesen e panelit, si më poshtë:

1. Nazmije Ibrahim, Gjyqtare e Gjykatës Supreme të Kosovës, Kryesuese e PZAP- it;
2. Muhamet Rexha, Gjyqtar i Gjykatës së Apelit – Prishtinë, anëtarë (i riemëruar);
3. Hasan Shala, Gjyqtar i Gjykatës së Apelit-Prishtinë, anëtarë (i riemëruar);
4. Ymer Hoxha, Kryetar i Gjykatës Themelore-Prizren, anëtarë (i riemëruar);

5. Nehat Idrizi, Gjyqtari Gjykatës Themelore-Prishtinë, anëtarë (i riemëruar);
6. Zyhdi Haziri, Kryetar i Gjykatës Themelore-Gjilan, anëtarë;
7. Fejzullah Rexhepi, Gjyqtar i Gjykatës Themelore – Ferizaj, anëtarë;
8. Afijete Sada, Gjyqtare e Gjykatës Themelore-Gjakovë, anëtare dhe
9. Faton Ademi, Gjyqtar i Gjykatës Themelore – Mitrovicë, anëtarë,.

2.1 Përbërja e PZAP-it

PZAP, përbëhet prej 10 (dhjetë) gjyqtarëve si anëtarë të panelit përfshirë këtu edhe kryesuesen.

Paneli e PZAP-it sipas LZP-së mund të mbledhen në përbërje prej se 3 (tre) anëtarëve.

Anëtarët e PZAP-it sipas LZP-së, gjashtëdhjetë (60) ditë para ditës së zgjedhjeve, deri në certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve, i japin përparësi të plotë obligimeve të tyre si anëtarë të PZAP-it.

Për çdo panel caktohet një kryesues i panelit për seancën e caktuar. Kryesuesi i Panelit të PZAP-it, i caktohet përbërjen e paneleve sipas Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it.

2.2 FUNKSIONET, PËRGJEGJËSIT DHE PËRBËRJA E SEKRETARIATIT TË PZAP-it

Duke u bazuar në nenin 123 të LZP-së PZAP-i, nështrimin e përgjegjësisë dhe funksioneve të tij ndihmohet nga Sekretariati.

Sekretariati i PZAP-it:

- pranon ankesa dhe apele gjatë procesit zgjedhor;
- arkivon të gjitha shkresat që parashtrihen në PZAP;
- Drafton/harton vendime të ndryshme;
- Me autorizim të panelit heton/mbledh fakte për vendosjen e ankesave të parashtruara në PZAP;
- Harton procesverbale për secilin rast gjatë zhvillimit të hetimeve se bashku me dëshmitarë të mbledhura i prezanton para panelit;
- Harton raporte të përgjithshme për rezultatin e hetimeve;
- Harton raportet preliminare për rastet që konsiderohen nga paneli se kanë elemente të veprës penale dhe i dorëzon në Prokurorinë Shtetërore të Republikës së Kosovës;

- Ofron ndihmën e nevojshme organeve të drejtësisë për ti hetuar rastet me elemente të veprës penale;
- Menaxhon dhe ekzekuton buxhetin vjetor;
- Përkthen vendimet në të gjitha gjuhët sipas ligjit për përdorimin e gjuhëve në Republikën e Kosovës;
- Mirëmban adresë zyrtare dhe qasje në informatat në çdo kohë.

Kryesuesi i Sekretariatit të PZAP-it, nën udhëheqjen e Kryetarit të PZAP-it, është përgjegjës për:

- Të gjitha çështjet administrative të ndërlidhura me funksionimin e PZAP-it;
- Përgatitjen e paneleve të PZAP-it, duke siguruar se i tërë materiali i nevojshëm është në dispozicion;
- Organizimin e Sekretariatit dhe zhvillimin e procedurave administrative për çfarëdo çështje që ka të bëjë me funksionimin e PZAP-it.
- Menaxhon buxhetin vjetor të ndarë nga Buxheti i Republikës së Kosovës për të mbuluar shpenzimet për funksionimin e PZAP-it, duke u bazuar nëpropozimbuxhetin e dorëzuar nga Kryesuesi i Sekretariatit të PZAP-it.


Me buxhetin e propozuar për vitin 2014 dhe i cili është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës PZAP-i, nuk ka pasur ndryshime nga viti paraprak sa i përket numrit të aprovuar të stafit, respektivisht i ka të lejuara 20 pozita, prej tyre: 1 (një) Kryetar të PZAP-it, 9 (nëntë) anëtarë të panelit të PZAP-it, 1 (një) Kryesues të Sekretariatit të PZAP-it dhe 9 (nëntë) zyrtarë të administratës.

Marrëdhënia e punës se personelit të sekretariatit të PZAP-it, rregullohet me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës të datës 13 maj 2010.

Sekretariati i PZAP-it, ka këtë strukturë të brendshme të organizimit:

- Kryesuesin e Sekretariatit i cili është ekuivalent me pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë,
- Udhëheqësin e Zyrës Ligjore të Sekretariatit, ekuivalent me pozitën e Drejtorit të Departamentit,
- Zyrtarin Kryesor Financiar, ekuivalent me pozitën e Drejtorit të Departamentit,
- Tre Zyrtarë të Lartë Ligjorë,
- Koordinatorin e Përkthimeve Shqip-Serbisht dhe anasjelltas,
- Zyrtarin për Teknologji Informative dhe Logjistikë,
- Asistentin Ekzekutiv/Arkiv dhe
- Zyrtarin e Transportit.

Organogrami i PZAP-it



3. Aktivitetet e PZAP-it dhe të Sekretariatit

PZAP-i, në zbatim të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, me qëllim të përmbushjes së funksioneve dhe përgjegjësi të tij të përcaktuara me këtë ligj dhe ligjet tjera të aplikueshme të Republikës së Kosovës, në fillim të vitit ka përgatitur dhe miratuar një plan të punës në të cilin plan janë paraqitur dhe përfshirë objektivat e Institucionit të PZAP-it për vitin 2014.

Në këtë plan vjetor për shkak të natyrës së mandatit të Institucionit të PZAP-it, detyrave dhe punëve që mund të këtë gjatë një viti, përveç paraqitjes së objektivave të rregullta ka pasur edhe objektiva alternative, siç janë: Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës.

PZAP-i, të gjitha objektivat e parapara në planin e punës i ka përmbushur si në aspektin kualitativ ashtu edhe në atë kuantitativ. Kryerja me sukses e procesit të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, ka qenë një prej aktiviteteve kryesore të realizuara në vitin 2014.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), gjatë tërë proceseve zgjedhore ka dëshmuar se është organ apolitik, i pavarur, i vendosur dhe i aftë në zgjidhjen e rasteve të ndryshme për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës të mbajtura më 8 qershor të vitit 2014.

PZAP-i, të gjitha ankesat dhe apelet e lejuara të parashtruara nga palët e interesuar për procesin zgjedhor të sipërshënuara i ka vendosur, bazuar në LZP, Rregullat Zgjedhore dhe Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, në afatet e parapara ligjore me çka Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), i ka mundësuar shpalljen e rezultateve përfundimtare dhe certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve.

Efikasiteti dhe efektiviteti i Institucionit të PZAP-it, i treguar në këtë proces zgjedhor të cekur me lartë si dhe në proceset zgjedhore të më hershme ka treguar dhe po tregon performancën e këtij Institucioni, e cila performancë është bërë e njohur për publikun dhe Institucionet e vendit dhe ndërkombëtare. Ngritja e performancë në kuptimin kualitativ e ka rritur besimin e publikut.

4. AKT EMËRIMET E SHËRBYESVE CIVIL DHE VLERËSIMET E PUNËSPËR PERSONELIN E SEKRETARIATIT TË PZAP-IT

PZAP-i, për vitin 2014 nuk ka pasur vende të lira për rekrutimin e stafit për arsye se të gjitha vendet e lejuara me buxhet i ka të plotësuara, në bazë të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës të datës 13 maj 2010 dhe akteve nënligjore të nxjerrura në pajtim me këtë ligj, i ka lëshuar akt emërimet e karrierës pa afat për të gjithë shërbyesit civil nga niveli me i ulët deri te niveli me i lartë si dhe është bërë vlerësimi i punës dhe performanca e zyrtarëve të sekretariatit të PZAP-it për vitin 2014.

4.1 Rekrutimi i Stafit jo permanent gjatë procesit zgjedhor 2014

PZAP-i, me qëllim të perballimit me sukses të procesit Zgjedhor të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura me 8 Qershor 2014, sipas nevojave dhe kërkesave të Institucionit është miratuar vendimi i PZAP-së, lidhur me angazhimin e dhjetë (10) punëtorëve të përkohshëm në Sekretariatit e PZAP-it, prej tyre 7 (shtatë) Zyrtarë Ligjor dhe 3 (tre) Asistentë Ekzekutiv. Kohëzgjatja e angazhimit të tyre ka qenë nga data 15 Maj 2014 deri 15 ditë pas certifikimit të rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve.

Procesi zgjedhor për Votuesit Jashtë Kosovës ka qenë edhe një tjetër sfidë për PZAP-in, mirëpo edhe në këtë proces zgjedhor përkushtimi i gjithë stafit të sekretariatit të PZAP-it, atij permanent dhe jopermanent si dhe të anëtareve të PZAP-it, është perballuar dhe tejkaluar me sukses edhe ankesat që janë ndërlidhur me Votimine Votuesve Jashtë Kosoves, ku gjatë këtij procesi në PZAP, janë pranuar, shqyrtuar dhe vendosur 9 172 ankesa.

Te gjitha këto ankesa PZAP-i, i ka shqyrtuar dhe ka marr vendim individual përbrenda afateve të parapara ligjore dhe njëkohësisht secila palë e përfshirë në proces është njoftuar me vendimin e marr nga PZAP-i, dhe ju ka dhënë këshilla juridike me mundësi që i lejohen nga ligji që ta ankimon vendimin e PZAP-it në Gjykatën Supreme.

4.2 Zyra Ligjore

Aktivitetet e Zyrtarëve të Zyrës Ligjore kanë qenë si në vijim:

- Aktiviteti lidhur me Mësimet nxjerra nga zgjedhjet e kaluara,
- Veprime administrative lidhur me hetimin e rasteve të ndryshme për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të vitit 2014;
- Përgaditja e përgjigjeve në ankesat e parashtruara në Gjykatën Supreme kundër vendimeve të PZAP-it,
- Hetimi i të gjitha rasteve që kanë pretenduar palët se janë bërë parregullsi në ditën e votimit,
- Monitorimin i subjektet politike, e kanë bërë apo nuk e kanë bërë evitimin e shkeljes së pretenduar sidomos gjatë fushatës zgjedhore dhe raportimi i kësaj çështje para paneli,
- Identifikimi dhe krahasimi i ankesave, ngase ka pas subjekte politike që në PZAP, kanë parashtruar ankesa të njëjta, por në periudha të ndryshme kohore,
- Hartimi i kërkesave për përgjigje në ankesa për subjektin politik që është në procedurë,
- Bashkëpunimi me Policinë e Kosovës sa i përket hetimeve për parregullsitë gjatë procesit të zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të vitit 2014,
- Bashkëpunimi me Prokurorinë e Shtetit lidhur me dorëzimin e rasteve që kanë elemente të veprës penale në bazë të KPK-së, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të vitit 2014,
- Përgatitja e shkresave të ndryshme për Gjykata të ndryshme nëpër Kosovë për rastet që janë në procedurë.

- Bashkëpunimi në vazhdimësi PZAP-it, me Zyrën për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim (ZRPPC) të Komisionit Qendror Zgjedhor –KQZ-së, lidhur me të gjitha aktivitetet e ndërlidhura të përcaktuara me LZP, siç janë periudha e sfidimit, konfirmimi i certifikimit të subjekteve politike dhe kandidatëve për pjesëmarrje në zgjedhje, ankesat që ZRPPC-ja i adreson PZAP-it për mos deklarimin e raportit financiar nga ana e subjekteve politike etj.

4.3 PËRKTHIMI I DOKUMENTEVE DHE QASJA NË INFORMATAT ZYRTARE

PZAP-i, në pajtim me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve të gjitha vendimet dhe dokumentet tjera zyrtare i ka përkthyer në gjuhët zyrtare.

Gjatë vitit 2014, zyra për koordinimin e përkthimeve ka përkthyer nga gjuha shqipe në atë serbe këto dokumente:

Vendimet e ndryshme të PZAP-it për Zgjedhjet parlamentare të vitit 2014 me të cilat vendime janë njoftuar palet e interesuara në gjuhën e tyre amtare, Raportin Vjetor të PZAP-it për vitin 2014, Raportin Financiar me të gjitha pjesët të tij për vitin 2014, Raportet tremujore të Buxhetit të PZAP-it për vitin 2014, Kërkesat Buxhetore, Njoftimet për Web faqe zyrtare të PZAP-it.

4.4 FAQJA ZYRTARE NË INTERNET

Për të kultivuar një frymë të transparencës të punës së tij, PZAP-i, për gjatë gjithë periudhës së procesit zgjedhor, ka qenë shumë aktiv në prezantimin/publikimin e të gjitha vendimeve të marra nga PZAP-i, në faqen zyrtare internet. Gjatë kësaj periudhe kohore në faqen zyrtare të PZAP-it, janë publikuar broshura me udhëzime se si të plotësohet një ankesë poashtu në faqen zyrtare kanë qenë të publikuar edhe formularët e ankesave ku ju ka mundësuar të gjithë të inetrseuarve ti shkarkojn formularët e ankesave dhe ti paraqesin pretendimet e tyre për parregullsi pran PZAP-it.

Si rezultat i një interesimi të madh të publikut për tu interesuar për plotësimin e ankesave dhe për të drejtat zgjedhore në email-in zyrtar të PZAP-it, janë pranuar qindra kërkesa për sqarime se si duhet të ankohen për parregullësit zgjedhore, të gjitha këto palë të interesuar kanë pranuar përgjigje për pytjet/kërkesat e tyre brenda 24 orëve nga momenti i pranimit të kërkesës në PZAP.

Gjithashtu në faqen zyrtare në internet të PZAP-it, mund të gjeni raporte vjetore të këtij institucioni që ju mund të njoftoheni për të gjitha aktivitetet dhe punët e përfunduara nga ky institucion.

5. KOMISIONET E PËRHERSHME TË PZAP-it

Me qëllim të ushtrimit sa më efikas të funksionit dhe përgjegjësive të tij PZAP-i, ka të formuara disa komisione të Përhershëmsiç janë:

KOMISIONET E PËRHERSHME TE PZAP-it

- 1 Komisioni për Çështje Ligjore i përberë prej 5 (pesë), anëtarëve të panelit,
- 2 Komisioni për Buxhet dhe Personel i përberë prej 5 (pesë), anëtarëve të panelit,

Komisioni për Çështje Ligjore është komision i përhershëm i cili përbehet nga anëtarë të PZAP-it të cilët në mënyrë të përhershme merren me çështjet ligjore që kanë të bëjnë me fushën kompetencave dhe të mandatit të Institucionit të PZAP-it, të përcaktuara me LZP dhe amendamentimin e Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it.

Ky komision në punëtoritë dhe takimet e mbajtura ka dhënë kontributin dhe ekspertizën profesionale lidhur me reformën zgjedhore sa i përket mandatit të PZAP-it, të përcaktuar me ligj. Në vazhdimësi komisioni për çështje ligjore bën identifikimin e mangësive ligjore dhe bën rekomandime se si të amandemtohen ato.

Komisioni për Buxhet është komision i përhershëm i cili përbehet nga anëtarë të PZAP-it të cilin në mënyrë permanente procedon çështjet e buxhetit dhe të personelit të PZAP-it. Ky komision në punëtoritë dhe takimet e mbajtura ka dhënë kontributin dhe ekspertizën profesionale në çështjet e buxhetit dhe personelit të sekretariatit si janë struktura organizative e sekretariatit, nxjerrjen dhe miratimin e Rregullores për Standardet e Organizimit të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në PZAP poashtu komisioni për buxhet në vazhdimësi i përcjell shpenzimet e buxhetit dhe inkasimet e gjobave të subjekteve politike.

KOMISIONET E PËRHERSHME TE SEKRETARIATIT

- 3 Komisioni Disiplinor i përberë prej Zyrtarëve të Lartë të Sekretariatit,
- 4 Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave i përberë prej Zyrtarëve të Lartë të Sekretariatit.

Komisioni Disiplinor i përberë prej Zyrtarëve të Lartë të Sekretariatit është komision i përhershëm i cili merret me çështjet e procedurave disiplinore dhe të ankesave të personelit të administratës së Sekretariatit, respektivisht me çështjet e marrëdhënies së punës të shërbyesve civil të sekretariatit.

Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave i përberë prej Zyrtarëve të Lartë të Sekretariatit, ka për qëllim zgjidhjen e kontesteve të ankesave nga personeli, përbrenda institucionit të PZAP-it.

Këto komisione mbajnë takime të rregullta mujore ku shqyrtohen çështje të rëndësishme nga fusha primaria e PZAP-it.

5.1 Komisionet e përkohshme të PZAP-it

1. Komisioni për Inventarizimin e Pasurisë,
2. Komisioni për Vlerësimin e Pasurisë dhe
3. Komisionet tjera të përkohshme,

Këto komisione kanë për qëllim menaxhimin dhe vlerësimin e pasurisë së PZAP-it, në pajtim me aktet nënligjore të Administratës Publike

6. PUNËTORITË E PZAP-IT TË MBAJTURA NË VITIN 2014

Më qëllim të ngritjes së efikasitetit në punë dhe harmonizimin e çështjeve të ndryshme PZAP-i, ka organizuar dy punëtori gjatë vitit 2014 në Durrës në periudha të ndryshme kohore.

Punëtorja e parë e organizuar nga PZAP-i është mbajtur nga data 20 – 23 Mars 2014, në të cilën punëtori është diskutuar si më posht:

- Sfidat që është ballafaqur PZAP-i, nga ankesat e votuesve jashtë Kosove për Zgjedhjet Lokale 2013 dhe gjetja e një zgjidhje më të mirë se si të veprohet në të ardhmen lidhur me këtë çështje;
- Inkasimi i gjobave të papaguara nga subjektet politike dhe mënyra/modaliteti i procedimi të vendime me gjoba në rastet kur subjektet politike nuk janë më aktive si subjekte politike në Kosovë, ndërsa ende nuk u kanë shlyer borxhet në PZAP.
- Prezantim i Raportit të punës së PZAP-it për vitin 2013;
- Mësimet e nxjerra nga Zgjedhjet Lokale 2013;
- Është bërë prezantim i planit të punës për vitin 2014;
- Ndërsa punëtorja tjetër e organizuar nga PZAP-i, në vitin 2014, ka qenë nga data 16 – 19 Shtator 2014, në të cilën punëtori është diskutuar si më posht:
- Identifikim i mangësive ligjore, si: Regjistrimi i kandidatëve, Fushata Zgjedhore dhe çështje tjera procedurale që ndërlidhen me proceset zgjedhore;
- Mësimet e nxjerra gjatë hetimit të rasteve në QNR dhe shtjellimi i një zgjidhje më të shpejt dhe më efektive në të ardhmen konform dispozitave të parapara ligjore;
- Është diskutuar dhe janë harmonizuar qendërimet se si PZAP-i, të vepron me vendime me gjoba shtesë, për subjektet politike të cilat nuk i shlyejn borxhet përbrenda afatit të caktuar për pagesën e gjobës në vendimet e PZAP-it.
- Është diskutuar për iniciimin e procedurës përbarimore për subjektet politike apo kandidatet e pavaruar të cilët nuk i kanë shlye borxhet e shqiptuara nga PZAP-i edhe pas paralajmërimeve të bëra për pagesën e gjobës.

Nga të gjitha ato që janë diskutuar në të dy punëtorit më lart janë nxjerr rekomandime dhe konkluzione se si të vepron PZAP-i, në të ardhmen.

6.1 Pjesëmarrja e anëtareve të PZAP-it dhe personelit të sekretariatit të PZAP-it në vizita dhe grupe punuese në vend dhe jashtë vendit

Anëtarët dhe Personeli i Sekretariatit të PZAP-it me qëllim të ngritjes dhe zhvillimit të kapaciteteve të brendshme të Institucionit dhe performancës së tij kanë marrë pjesë brenda dhe jashtë vendit në vizita studimore, trajnime dhe seminare të ndryshme.

6.2 Vizitanë Maqedoni

Një delegacion i PZAP-it në përbërje nga Kryesuesii PZAP-it, dy anëtarë të panelit, kryesuesi i Sekretariatit, Udhëheqësi i Zyrës Ligjore dhe dy zyrtarë tjerë të Sekretariatit të PZAP-it, kanë marrë pjesë në vëzhgimin e procesit zgjedhor të Zgjedhjeve të Jashtëzakonshme Parlamentare dhe në vëzhgimin e raundit të dytë të Zgjedhjeve Presidenciale në Republikën e Maqedonisë të mbajtura me 27 Prill 2014, e cila vizitë është organizuar me qëllim të ngritjes së kapaciteteve profesionale të Institucionit, përfitimin e njohurive dhe këmbimin e përvojave me institucionet e Republikës së Maqedonisë të cilat merren me organizimin e Zgjedhjeve dhe mbrojtjen e të drejtës së votës.

Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të zyrtarëve të Sekretariatit të PZAP-it, stafi i sekretariatit i përbere nga grupe të zyrtareve kanë marrë pjesë në disa trajnime brenda dhe jashtë vendit, ku në trajnimet e cekura janë trajtuar temat si :Rregullat Financiare dhe Pasurive, Ndashja e tyre me Ligjin e Prokurimit Publik, Komunikimi me Media dhe Qasja në Dokumente Publike, Procedurat e Komisioneve Disiplinore dhe Ankesave në Shërbimin Civil, Ekzekutimi i Buxhetit si dhe Raportimet sipas Ligjit mbi Financimin e Finacave Publike dhe Përgjegjësive dhe Standardeve të Kontabilitetit, Menaxhimi, Klasifikimi, Afatet e Ruajtjes dhe Qasja në Dokumente Zyrtare, Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli sipas Standardeve Ndërkombëtare COSO dhe INTOSAI, Mbyllja e vitit fiskal dhe raportimi financiar sipas rregullave financiare të Thesarit.

7. NDARJET BUXHETORE

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa është organizatë buxhetore, me kod organizativ 247 dhe me kod funksional 0133. PZAP-i financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës

Raporti vjetor i shpenzimeve për vitin fiskal 2014 përmban të gjitha shpenzimet e krijuara gjatë këtij viti. Ky raport është përgatitur në pajtim me LMFP (03/L-48) dhe SNKSP dhe sipas parimit të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme. Politikat kontabël janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme gjatë tërë periudhës së realizimit të shpenzimeve.

Baze për hartimin e dokumentit kanë shërbyer raportet e SIMFK, të dhënat nga sektori i financave si librat, faturat, raportet e pranimit të mallit, kontratat dhe dokumentet tjera të PZAP-it.

Të gjitha pagesat janë bërë në sistemin e kesh-it (parave të gatshme) e jo të zotimit.

Valuta raportuese është euro (€)

Shumat raportuese janë në njësi në €

7.1 BUXHETI I PLANIFIKUAR PËR VITIN - 2014

Për vitin 2014 për Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa Qeveria e Republikës së Kosovës ka ndare buxhet në shumë prej 269,000.00€.

Buxheti i aprovuar i PZAP-2014

| Përshkrimi | Buxheti i aprovuar 2014 | Buxheti i ndryshuar gjatë vitit |
|----------------------------|-------------------------|---------------------------------|
| Paga dhe mëditje | 160,184.00 | 160,184.00 |
| Mallra dhe shërbime | 99,616.00 | 84,674.00 |
| Shërbime Komunale | 9,200.00 | 7,820.00 |
| Total | 269,000.00 | 252,678.00 |

Sa ju përket ndarjeve buxhetore të PZAP-it për vitin 2014, buxheti është ndarë në shumë prej 269,000.00€, Gjatë vitit 2014 ky buxhet ka pësuar ndryshime sipas vendimit të Qeverisë nr. 07/172 të datës 17 shkurt 2014 me të cilin vendim nga Organizatat Buxhetore është kërkuar Kursim i Shpenzimeve në nivelin 15% të shumës së alokuar nga ndarjet buxhetore nga kategoria ekonomike Mallra&Shërbime dhe Shërbime Komunale për vitin 2014, sipas Ligjit nr.04/L-233 për Buxhetin e Republikës së Kosovës. PZAP-i nga këto kursime ka deklaruar shumën prej **16,322.40€ - 15%** nga mallrat&shërbimet dhe shërbimet komunale ku gjithsejtë nga zbritja e kursimeve të deklaruara buxheti i PZAP-it ka mbetur në vlerë prej **252,678€**.


Struktura e buxhetit për vitin 2014

Duke analizuar buxhetin e PZAP-it në shumë prej 269,000.00 € si dhe strukturën buxhetore rezultojnë se prej tyre:

63.39 % të fondeve janë akorduar për mbulimin e shpenzimeve për paga dhe mëditje,

33.51 % të fondeve është akorduar për shpenzime mallra dhe shërbime,

3.09 % për shpenzimet komunale.



7.2 BUXHETI I SHPENZUAR PER VITIN 2014

Pas aprovimit të buxhetit për vitin 2014, në përputhshmëri me planin operacional, është bërë menaxhimi i fondeve të akorduara për Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa. Buxheti është realizuar me korrektësi sipas zërave të shpenzimeve dhe me efektivitet duke treguar kujdes që fondet e miratuara të shpenzohen sipas planit në kohën e duhur dhe me një administrim ekonomik efektiv.

Realizimi i buxhetit, përkatësisht shpenzimet e PZAP-it për vitin 2014 sipas kategorive ekonomike i shprehur edhe në përqindje duket në vijim:

Tabela Buxhetit me ndryshime dhe Shpenzime -2014

| Kategoritë Ekonomike | Total buxheti i Aprovuar-2014 | Buxheti i ndryshuar gjatë vitit-2014 | Buxheti i shpenzuar-2014 | Përqindja (%) |
|----------------------------|-------------------------------|--------------------------------------|--------------------------|---------------|
| Paga dhe mëditje | 160,184.00 | 160,184.00 | 138,468.05 | 85.90% |
| Mallra dhe shërbime | 99,616.00 | 84,674.00 | 73,121.73 | 86.35% |
| Shërbime Komunale | 9,200.00 | 7,820.00 | 7,796.95 | 99.70% |
| Total: | 269,000.00 | 252,678.00 | 219,386.73 | 86.82% |

a) Paga dhe mëditjet

Për vitin 2014 për Kategorinë se Pagave dhe Mëditjeve janë planifikuar mjete në vlerë prej 160,184.00€. Janë realizuar 138,468.05€ apo buxheti është shpenzuar 85.90%.

Dallimi në mes të Planifikimit dhe realizimit të Buxhetit është se të gjithë anëtarët e Panelit pagën në PZAP e marrin si pagë sekondare ndërsa ne jemi të obliguar të planifikojmë

Buxhetin në bazë të Vendimit të Qeverisë, andaj këtu na del një ndryshim në mes Buxhetit të

Planifikuar dhe të Realizuar sa i përket kategorisë se Pagave dhe Mëditjeve.

Mirëpo shpenzimi i Buxhetit në kategorinë e pagave dhe mëditjeve këtë vit ka qenë më i madh krahasuar me vitet e kaluara, respektivisht për vitin 2014 janë shpenzuar 138,468.05€ ose 86% e buxhetit të pagave.

Kjo ka ndodh për arsye se ky vit ka qenë vit Zgjedhor – ku me 8 qershor 2014 janë mbajtur Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare të Republikës së Kosovës e për këtë proces zgjedhor PZAP-i ka angazhuar anëtarët e PZAP-it dhe stafin e sekretariatit për të punuar me orar të zgjatur ditëve të punës si dhe vikendeve dhe për këtë arsye stafi ka marr kompensim shtesë në paga për tre muaj me Vendim të Qeverisë. Me buxhetin e vitit 2014 nga kategoria Paga e Mëditje është mbuluar edhe rritja e pagave 25% sipas vendimit të Qeverisë.

b) Mallra dhe shërbime

Për vitin 2014 janë planifikuar mjete në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve në shumë prej 99,616.00€. Këto mjete u shpenzuan në shumë prej 73,121.73€ apo buxheti është shpenzuar 86.35%. Këto shpenzime janë realizuar nëpërmjet:

- Modullit të aprovimeve dhe
- Modullit të blerjeve-prokurimit.

Me poshtë janë te prezantuara shpenzimet e kategorisë në mallra dhe shërbime për vitin 2014.

Mallra dhe shërbime

në €

| Kategoritë ekonomike | Shpenzimet -2014 |
|---|------------------|
| Mallra dhe Shërbime | 73,121.73 |
| Shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit | 20,568.96 |
| Shërbimet e Arsimit dhe trajnimit | 9,671.60 |
| Shërbimet tjera telefonike vala 900 | 7,100.00 |
| Shërbimet kontraktuese tjera | 10,200.00 |
| Shërbimet postare | 30.05 |
| Harduer për teknologji informative < 1000 | |
| Furnizimi për Zyre | 7,810.00 |
| Shërbime teknike | |
| Karburant për vetura | 3,654.43 |
| Sigurimi i automjeteve | 799.59 |
| Regjistrimi i automjeteve | 235.00 |
| Mirëmbajtja, riparimi i automjeteve | 3,976.50 |
| Mirëmbajtja e ndërtesave | 2,970.00 |
| Mirëmbajtja e Teknologjisë Informative | 2,329.28 |
| Shpenzimet për informim publik | 1,206.23 |
| Pajisje trafiku | |
| Drekat zyrtare | 2,569.70 |


c) Shpenzimet komunale

Buxheti i aprovuar i shpenzimeve komunale për Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa është ne shumë prej 7,820.00€. Krahasuar me buxhetin e planifikuar shpenzimet u realizuan 99.70%, çka do të thotë se buxheti është shpenzuar 7,796.95€.

7.3 PJESA PËRMBYLLSE E RAPORTIT TË SHPENZIMEVE

Në bazë të dhënave të SIMFK dhe databazës të Sekretariatit të PZAP-it mund të përfundojmë se për vitin 2014 Buxheti u shpenzua **219,386.73€**. Pjesë përmbyllëse e këtij raporti të shpenzimeve është paraqitja grafike e planifikimit dhe realizimit të Buxhetit për vitin 2014.

Paraqitja grafike e buxhetit të planifikuar dhe shpenzuara të PZAP-it për vitin 2014



7.4 TE HYRAT E PZAP-it

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP-i)) në bazë të nenit 120 paragrafi 1. pika c. të Ligjit Nr.03/L-256 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-073 Për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare të Republikës së Kosovës të mbajtura më 8 qershor - 2014, ka shqiptuar gjopa ndaj subjekteve politike në shumë prej 86,700.00 euro.

Në tabelën e më poshtme janë paraqitur të gjitha gjobat e shqiptuara dhe të realizuara për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare të Republikës së Kosovës të mbajtura më 8 qershor-2014.

| Nr. | Subjekti politik | Shuma e gjobës në euro | Pagesa e gjobës | Mbetja e borxhit | Data e pageses se borxhit |
|--------------------------------|--|------------------------|-----------------|------------------|---------------------------|
| 1 | Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) | 3,900 | 1,950 | 1,950 | 06.02.2015 |
| 2 | Partia Demokratike e Kosovës (PDK) | 57,900 | 28,950 | 28,950 | 06.02.2015 |
| 3 | Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) | 10,200 | 10,200 | 0 | 09.12.2014 |
| 4 | Lëvizja Vetëvendosja (LVV) | 3,500 | 3,500 | 0 | 18.08.2014 |
| 5 | NISMA për Kosovën | 9,200 | 4,600 | 4,600 | 06.02.2015 |
| 6 | Kosova Demokratik Partisi Turk (KDTP) | 1,350 | 1,350 | - | 03.12.2014 |
| 7 | Grupi Tradicionale Shqiptar (GTSH) | 250 | - | 250 | |
| 8 | VAKAT | 400 | 400 | 0 | 26.12.2014 |
| Totali i përgjithëshem: | | 86,700.00 | 50,950 | 35,750.00 | |

Siç jeni në dijeni gjatë vitit 2014 janë mbajtur Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare të Republikës së Kosovës të mbajtura më 8 qershor - 2014, ku PZAP ka shqiptuar gjoba ndaj subjekteve politike në shumë prej 86,700.00 euro. Nga kjo shumë e shqiptuar e gjobave Subjektet Politike kanë paguar borxhin në shumë prej 50,950.00 euro çka do të thotë se kanë mbetur pa u paguar edhe shuma prej 35,750.00 euro. Në mënyrë të rregullt gjobat i ka paguar LDK-ja, LVV, KDTP-ja dhe VAKAT. Ndërsa PDK, AAK dhe NISMA për Kosovën, këtyre Subjekteve nga KQZ-ja ju kanë ndal gjysma e borxhit nga Fondi për Demokratizim që e menaxhon KQZ-ja, kështu që në bazë të informatave që kemi nga KQZ-ja gjysmën tjetër të borxhit e paguajnë në tremujorin e dytë të vitit kur ju bëhet alokimi i mjeteve kështu kanë arritur marveshje KQZ-ja me këto Subjekte Politike, ndërsa GTSH (Grupi Tradicional Shqiptar) shumë prej 250 euro ende nuk e ka paguar.

Gjobat e shqiptuara dhe të pa paguara te subjekteve politike dhe kandidatëve te pavarur për zgjedhjet lokale 2013

| Nr. | Nr. I vendimit te PZAP ish KZAP-it | Subjekti politik | Data e marrjes se Vendimit | Shuma e gjobës në euro | Pagesa e gjobës | Mbetja e borxhit | Data e pageses se borxhit |
|-------------------------------|------------------------------------|-------------------------------------|----------------------------|------------------------|-----------------|------------------|---------------------------|
| 95 | Anr. 300/2013 | G.I Narodna Incijativa | 25.10.2013 | 400.00 | | 400.00 | |
| | Anr.270/2013 | Iniciativa Qytetare për Klinë (IQK) | 25.10.2013 | 250.00 | | 250.00 | |
| 97 | Anr.977/2013 | Nisma Qytetare për Ferizaj (NQF) | 04.12.2013 | 250.00 | | 250.00 | |
| | Anr.320/2013 | Nisma Qytetare për Prizrenin (NQP) | 25.10.2013 | 250.00 | | 250.00 | |
| 103 | Anr. 26/2014 | Hajrullah Shehu-Kandidat I Pavarur | | 200.00 | | 200.00 | |
| | Anr. 27/2014 | Isuf Musliu - Kandidat I Pavarur | | 200.00 | | 200.00 | |
| 104 | Anr. 31/2014 | Gl. Nove Snage | | 1,500.00 | | 1,500.00 | |
| | Anr. 33/2014 | KTB | | 3,000.00 | | 3,000.00 | |
| Totali i përgjithshëm: | | | | 6,050.00 | 0.00 | 6,050.00 | |

Nga gjobat e shqiptuara te Subjekteve Politike dhe Kandidateve të Pavarur në Zgjedhjet Lokale 2013 kanë mbetur borxhe në shumë prej 6,050.00€.

Gjobat e pa paguara te subjekteve politike për zgjedhjet e përgjithshme parlamentare 2010/11

| Nr. | Nr. I vendimit te PZAP ish KZAP-it | Subjekti politik | Data e marrjes se Vendimit | Shuma e gjobës në euro | Pagesa e gjobës | Mbetja e borxhit |
|---------------|------------------------------------|------------------|----------------------------|------------------------|-----------------|------------------|
| 3 | Anr.426/2010 | LDD | 23.12.2010 | 2,500 | 0.00 | 2,500 |
| 5 | Anr.389/2010 | FER | 12.12.2010 | 1,500 | 0.00 | 1,500 |
| 6 | Anr.434/2010 | FER | 23.12.2010 | 1,550 | 0.00 | 1,550 |
| Total: | | | | 5,550 | 0.00 | 5,550 |

Në Zgjedhjet e Përgjithshme Parlamentare të vitit 2010/11 janë mbetur obligime të pa paguara në shumë prej 5,550€. Shumen prej 2,500€ nuk e ka paguar LDD-ja dhe shumën prej 3,050€ nuk e kanë paguar FER-i.

Gjobat e shqiptuara dhe të pa paguara të subjekteve politike dhe kandidatëve të pavarur për zgjedhjet lokale 2009/10

| Nr. | Nr. I vendimit të PZAP ish KZAP-it | Subjekti politik | Data e marrjes së Vendimit | Shuma e gjobës në euro | Pagesa e gjobës | Mbetja e borxhit |
|---------------|------------------------------------|----------------------|----------------------------|------------------------|-----------------|------------------|
| 2 | Anr.79/2010 | DRK | 23.02.10 | 1,500 | 0.00 | 1,500 |
| 3 | Anr.83/2010 | PLK | 23.02.10 | 4,800 | 0.00 | 4,800 |
| 5 | Anr.81/2010 | RRKPZ | 23.02.10 | 4,800 | 0.00 | 4,800 |
| 6 | Anr.85/2010 | PRSH | 23.02.10 | 1,500 | 0.00 | 1,500 |
| 7 | Anr.86/2010 | GIO | 23.02.10 | 500 | 0.00 | 500 |
| 9 | Anr.88/2010 | SDP | 01.03.10 | 3,200 | 0.00 | 3,200 |
| 11 | Anr.90/2010 | JSZH | 23.02.10 | 500 | 0.00 | 500 |
| 12 | Anr.91/2010 | ZBB | 23.02.10 | 500 | 0.00 | 500 |
| 13 | Anr.92/2010 | ZEG | 23.02.10 | 500 | 0.00 | 500 |
| 14 | Anr.93/2010 | KP. Bajram Islami | 01.03.10 | 200 | 0.00 | 200 |
| 16 | Anr.95/2010 | KP. Mexhit Foniqi | 01.03.10 | 200 | 0.00 | 200 |
| 18 | Anr.97/2010 | KP. Adem Haxhi Gashi | 23.02.10 | 200 | 0.00 | 200 |
| 19 | Anr.98/2010 | KP. Naim Mustafa | 23.02.10 | 200 | 0.00 | 200 |
| 20 | Anr.99/2010 | KP. Hasan Bilalli | 23.02.10 | 200 | 0.00 | 2000 |
| 21 | Anr.100/2010 | KP. Ahmet Krasniqi | 23.02.10 | 200 | 0.00 | 200 |
| Total: | | | | 19,000 | 0.00 | 19,000 |

Në Zgjedhjet Lokale të vitit 2009/10, kanë mbetur pa paguar borxhe në shumë prej 19,000€. Në tabelë janë të paraqitura në mënyrë detale për secilin Subjekt Politik. Obligime të pa paguara nga Subjektet Politike dhe Kandidatet e Pavarur gjithsejtë për të gjitha vitet kanë mbetur edhe 66,350€.

Gjatë vitit 2014 në llogarinë e të hyrave të PZAP-it ka pasur realizim të hyrave në shumë prej 201,799.99€, ku ky fond i mbledhur transferohet dhe mbahet në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

8. BASHKËPUNIMI I PZAP-IT ME INSTITUCIONET INSTITUCIONET QË NDËRLIDHEN ME PROCESE TË ZGJEDHJEVE

PZAP-i ka bërë përpjekje të vazhdueshme që të ketë bashkëpunim ndërinstitucionale sidomos me institucionet që nërlidhen me procese zgjedhore, si i përpjekjeve siç dihet në dy palë zgjedhjet e fundit të vitit 2013 dhe të vitit 2014 ka pas përmirësime si në procesin zgjedhor ashtu është në bashkëpunimin ndërinstitucional. Gjithmon PZAP-ka pasur dhe vazhdon të ketë bashkëpunimin të mirë me institucionet e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, duke shpresuar se edhe në të ardhmen dokëtë bashkëpunim për arsye të natyrës së punëve dhe mandatit të PZAP-it, në luftimin dhe vendosjen për të gjitha parregullsi të zgjedhore siç edhe është edhe përcaktuar me ligj.

8.1 Bashkëpunimi i PZAP-it me Komisionin Qendror Zgjedhor - KQZ

- Bashkëpunimi i PZAP-it dhe KQZ-në, është i bazuar në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës (LZP). Ky bashkëpunim është i përhershëm i arsyeshëm, i nevojshëm dhe i detyrueshëm para, gjatë dhe pas proceseve zgjedhore ngase ashtu edhe përcaktohet me LZP.
- Bashkëpunimi i PZAP-it me Zyrën për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim (ZRPPC) të KQZ-së, ka rezultuar me një bashkëpunim të ngushtë nga fillimi e deri në përfundim të procesit zgjedhor për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare 2014 në të gjitha fazat e gjithë procesit të zgjedhjeve.
- Ky bashkëpunim në mes të PZAP-it dhe KQZ-së, ka rezultuar përmes shkresave të natyrave të ndryshme siç janë: Kërkesat e PZAP-it për tu përgjigjur në ankesa ndaj vendimeve të KQZ-së, të cilat vendime palët i kanë ankimuar në PZAP, kërkesa për të ofruar PZAP-it tërë materialin zgjedhor për hetim për Qendrat e Votimit që janë parashtruar ankesa. Në anën tjetër PZAP-i e ka njoftuar KQZ-në për përfundimin e procesit ankimor dhe vendosjen e të gjitha ankesave nga ana e PZAP-it dhe se KQZ-ja pas këtij konfirmimi nga PZAP-i ka certifikuar rezultatet përfundimtare të Zgjedhjetë Parakohshme Parlamentare të 8 Qershorit 2014, poashtu PZAP-i ka njoftuar KQZ-në, për gjobat e paguara dhe të papaguara nga subjektet politike për zgjedhjet paraprake gjë e cila i ka mundësuar KQZ-së certifikimin e subjekteve politike për të garuar në Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare të 8 Qershorit 2014 si dhe njoftimi bërë nga ana e PZAP-it për KQZ-në, për të gjithë personat të cilët janë dënuar me vendim të PZAP-it të cilëve ju është ndaluar që të mos jenë pjesë e stafit administrativ në zgjedhje për periudhën kohore të caktuar në vendim dhe po ashtu ndalesa të jenë kandidatë të ndonjë subjekti politik.

8.2 Bashkëpunim i PZAP-it, me Policinë e Kosovës

Ky bashkëpunim në mes të PZAP-it me Policinë e Kosovës (PK) ka qenë prej fillimit e deri në përfundimin e procesit zgjedhor për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare të 8 Qershorit 2014, sa i përket progresit të hetimeve për parregullsitë gjatë procesit zgjedhor dhe sigurisë së procesit zgjedhor. Gjatë kësaj kohe këto dy institucione kanë pasur një bashkëpunim të mirë në mes veti. Ky bashkëpunim ka rezultuar me një numër të madh të rasteve të cilat janë adresuar në PK, me qëllim të hetimit të rasteve për parregullsitë gjatë fushatës zgjedhore e sidomos për parregullsitë gjatë ditës së votimit. PK, për të gjitha rastet dhe për hetimet e bëra lidhur me parregullsitë pretenduara ka raportuar në PZAP, me kohëdhe brenda afatit ligjor. të përcaktuar me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme.

PZAP-i, për ankesat që lidhen më ditën e votimit duhet vendosur brenda 72 orëve, që në shumë raste raporti i policisë ka qenë shumë i rëndësishëm për tu marr vendimi lidhur me ankesën e parashtruar në PZAP. PK, ka arritur me sukses që ti sjell raportet policore nga vendi i ngjarjes brenda afatit të caktuar nga PZAP-i.

8.3 Bashkëpunimi i PZAP-it, me Gjykatën Supreme të Kosovës

Bashkëpunimi me Gjykatën Supreme të Kosovës, PZAP-i ka pasur një bashkëpunim të mirë e që kryesisht kishin të bënin lidhur me apelimin e vendimeve të PZAP-it për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare të 8 Qershorit 2014 nga votuesit brenda Kosovës dhe nga Votuesit Jashtë Kosovës. Për të gjitha rastet PZAP-i, i është përgjigjur Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës në kërkesat për përgjigje në ankesë për rastet e ankesave ndaj vendimeve të PZAP-it. PZAP-i me këtë rast përveç përgjigjes me shkrim, Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës i ka bashkëngjitur edhe të gjitha shkresat e lendes lidhur me ankesën si dhe ndonjë sqarim shtesë nëse është kërkuar nga Gjykatata..

8.4 Bashkëpunimi i PZAP-it, me Gjykatat Themelore në Kosovës

Gjatë vitit 2014, PZAP-i ka bashkëpunuar me Gjykatat Themelore të Kosovës lidhur me rastet të cilat janë në procedurë për të gjitha zgjedhjet lokale dhe ato parlamentare të mbajtura më herët. Në të shumtën e rasteve nga PZAP-i është kërkuar prezenca e një përfaqësuesi të tij gjatë shqyrtimit kryesor, si dhe janë kërkuar dëshmi shtesë për rastet për të cilat është duke u zhvilluar procedurë gjyqësore. Për të gjitha rastet që janë në procedurë për zgjedhjet paraprake e për të cilat raste kërkohej informata shtesë, PZAP-i ju ofron informata dhe të gjitha dëshmitë që i posedon ky institucion lidhur me rastet në fjalë.

8.5 Bashkëpunimi i PZAP-it, me Komisionin e Pavarur të Mediave (KPM)

Me KPM-në, PZAP gjatë vitit 2014 ka bashkëpunuar për rastet për rastet për të cilat është pretenduar nga pala ankuese se disa media kanë thyerheshitjen zgjedhore duke bërë fushatë për subjekte politike të caktuar dhe kandidatë të tyre gjatëheshitjes zgjedhore. Në këto raste PZAP-i, ka kompletuar lëndën më të gjitha shkresat tjera përcjellse dhe ka dorëzuar në kompetencë për shqyrtim dhe vendosje të mëtutjeshme në KPM-ë.

8.6 Bashkëpunimi i PZAP-it, me Prokurorinë e Shtetit

Ky bashkëpunim në mes të këtyre dy institucioneveka të bëjë kryesisht me rastet që kanë elemente tëveprës penale të parapara nëbazë të KPRK dhe LZP-së. Andajtë gjitha rastet të cilat kanë elemente të veprës penale PZAP-i, i dorëzon në Prokurorinë Shtetërore. Në Prokurorinë e Shtetit mënyra e dorëzimit të rasteve me elemente të veprës penale bëhet në këtë mënyrë: PZAP-i së pari e përgatit një raport preliminar lidhur më secilin rast,i bashkangjet lëndës të gjitha shkresat që lidhen më atë rast dhe përgatit një shkresë përmbledhës për të gjitha lëndët, dhe në fund PZAP-i, bënë dorëzimin e rasteve në Prokurorin Shtetërore. Edhe përkundër kësaj PZAP-i prapë bashkëpunon më prokurorin e shtetit lidhur me rastet që janë në procedurë ashtu që prokuroria për rastet që janë në procedurë varësisht nga nevoja kërkon informata shtesë nga PZAP-i.

8.7 Bashkëpunimi i PZAP-it, me Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian – OSBE

Në kuadër të bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare PZAP-i dhe OSBE-nëvazhdimësi kanë bashkëpunimtë shkëlqyer mes veti dhe se ky bashkëpunim në mes të këtyre institucioneve më së shumti ka qene gjatë procesit zgjedhorpër Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, por edhe gjatë gjithë kohës Zyrtarët e PZAP-it dhe ata të Departamentit për Zgjedhje të OSBE-së, vazhdimisht kanë pasur dhe vazhdojn të kenë takime të rregullta javore në të cilat takime është diskutuar dhe trajtohen çështjet që lidhem meveprimtarin e PZAP-it. Ky bashkëpunim ka rezultuar edhe me ngritjen e kapaciteteve te personelit te Sekretariatit te PZAP-it ku me ç'rast OSBE ka organizuar dhe ka mbajtur trajnime nga këto tema si më poshtë:

- Trajnimin lidhur me hetimet në Qendrën e Numërimit dhe të Rezultateve. Në këtë trajnim janë mësuar çështjet rreth asaj se si duhet të bëhet një hetim në QNR duke i demonstruar praktikisht se si bëhet një hetim në QNR, pastaj se si duhet të jet një kuti e votimit që ligjërisht të konsiderohet në rregull dhe se si nuk duhet të jetë ajo kuti e votimit.

- Çështje tjetër ka qenë trajnimi lidhur më votimin më postë, me ç'rast është shpjeguar dhe sqaruar egjithë procedura operationale se si votohet nëpërmes postes.

OSBE ka ndihmuar PZAP-in, shumë edhe ne lehtësimin rreth procedurës për administrimin e ankesave te votuesve jashtë Kosovës te cilët kanë parashtruar ankesa kundër vendimeve te KQZ-së. Kjo fazë dhe ky procesi i administrimit te votimit për Votuesit Jashtë Kosovës ka qene një proces mjaft sfidues për PZAP-in.

Në lehtësimin e procesit te votimit te Votuesve Jashtë Kosovës për Zgjedhjet e 8 Qershorit 2014, Personeli i Divizionit te Zgjedhjeve te OSBE-se, pasi që i kanë marr ankesat nga Votuesit Jashtë Kosove konkretisht nga posta në Republikën e Serbisë ankesat i kanë dorëzuar ne PZAP. Gjate këtij procesi te votimit OSBE ka dorëzuar në PZAP, gjithsejtë 9172 ankesa, nga Votuesit Jashtë Kosove.

PZAP-i, për te gjitha ankesat e pranuarat i ka shqyrtuar dhe i ka vendosur brenda afateve te parapara ligjore dhe për te njëjtat ankesa ka marre vendime, ndërsa për ta lehtësuar punën e PZAP-it, për dërgimin e këtyre vendimeve te palët e përfshira ne procedurë, PZAP-i ka kërkuar ndihmën e OSBE-së, i cili institucion pa hezitim ju është përgjigjur pozitivisht dhe e ka bërë shpërndarjen e të gjitha vendimeve që kanë pas të bëjnë me votuesit jashtë Kosove.

Githashtu Misioni i i OSBE-se ne Kosove ne vazhden e përkrahjes se PZAP-it ka organizuar nje takim te përbashket pune ne mes te anetareve te PZAP-it dhe anetareve te KQZ-se i cili takim eshte mbajtur me 25 nentor 2014 i dhe ka pasur per qellim permiresimin e bashkëpunimit dhe komunikimit ne mes te ketyre dy institucioneve.

Nga ky takim i përbashket pune eshte rekomnadur qe stafi i sekretariateve te KQZ-se dhe PZAP-it te organizojne takime te përbashketa pune te identifikojne problemet eventuale gjate procesve zgjedhore dhe gjate kryerjes se puneve te përditshme si dhe te informojne nivelet me te larte te ketyre dy institucioneve KQZ-se dhe PZAP-it dhe ne takime te përbashketa pergjegjesit e institucioneve te diskutojne mundesine e tejkalimit te ketyre problemeve eventuale dhe te lehtesojne funksionimin e institucionit gjate proceseve zgjedhore dhe kryerjes se puneve te perdisthme te përcaktuara me LZP dhe Ligjet e aplikueshme te Kosoves.

Poashtu OSBE-e bashkë me IFES-in është duke ndihmuar PZAP-in në krijimin e një Sistemi te Menxhimit te lendeve Ankesave&Apeleve per proceset zgjedhore. Per kete Sistem te menaxhimit te lendeve OSBE, ka ofruar përkrahje profesionale permes eksperteve ligjore te OSBE-se ndersa IFES ka ofruar ndihme financiare dhe profesionale. PZAP-i per krijimin e këtij sistemi te menaxhimit te lendeve ka siguruar te gjitha informatat nevojshme dhe ekspertizne profesionale.

Ky sistem do te siguroj dhe do te lehtësoj funksionimin e Institucionit te PZAP-it gjate procesve zgjedhore.

8.8 Bashkëpunim i PZAP-it, me IFES-in

PZAP-i, ka bashkëpunuar edhe me IFES-in, ku ky bashkëpunim ka rezultuar me informimin publik për qytetarët se si duhet të plotësohet një formularë i ankesës dhe cilat janë parregullsitë zgjedhore për të cilat mund të parashtrahet ankesë në PZAP.

IFES-i, e ka ndihmuar PZAP-in, në informimin e opinionit publik lidhur më plotësimin e formularëve të ankesave, nëpërmes publikimit reklamave në TV, radio, gazetave, portaleve të ndryshmeve si dhe nëpërmes banerave të cilët kanë qenë të vendosur në secilën Qendër të Votimit gjatë ditës së zgjedhjeve më të cilën janë informuar votuesit se si mund të parashtrahet ankesa në PZAP lidhur më parregullsitë eventuale që mund të hasin gjatë procesit të votimit. Poashtu IFES bashkë me OSBE-n është duke ndihmuar PZAP-in në krijimin e një Sistemi të Menaxhimit të lendeve Ankesave&Apeleve për proceset zgjedhore. Për këtë Sistem të menaxhimit të lendeve IFES ka ofruar ndihmë financiare dhe profesionale ndërsa OSBE, ka ofruar përkrahje profesionale. PZAP-i për krijimin e këtij sistemi të menaxhimit të lendeve ka siguruar të gjitha informatat nevojshme dhe ekspertizë profesionale.

Ky sistem do të sigurojë dhe do të lehtësojë funksionimin e Institucionit të PZAP-it gjatë procesve zgjedhore.

IFES, gjatë vitit 2014, ka organizuar tri punëtori, me qëllim që të mbledhen të gjitha informatat për krijimin e një data baze në të cilat punëtori ka qenë dhe ka kontribuar mjaft shumë edhe përfaqësi i OSBE-së.

9. PËRMBLEDHJEEKZEKUTIVEDHESTATISTIKAPËR ZGJEDHJETE PARAKOHSHME PARLAMENTARE TË VITIT 2014

Pas shpalljes zyrtare të ditës së zgjedhjeve, respektivisht caktimit të datës së Zgjedhjeve të Parakohshme Parlamentare të datës 08.06.2014, PZAP-i ka filluar zbatimin e planit të punës për këtë proces zgjedhor. PZAP-i, gjatë këtij procesi zgjedhore ka organizuar kujdestarin, respektivisht ka caktuar orarin e punështesë për stafin e sekretariatit.

Është e domosdoshme që orari i punës në fazën e procesit zgjedhor të zgjatet. Orari i punës minimumi katër orë zgjatët për të gjitha ditët e javës, zyrtarët dhe panelistët e PZAP-it, janë të gatshëm në çdo kohë të bëjnë pranimin e ankesave, procedimin dhe vendosjen e tyre brenda afateve ligjore, ngase siç dihet afatet ligjore për të vendos për ankesa janë shumë të shkurtra prandaj komplet sekretariti i PZAP-it duhet të qëndroj për të pranuar ankesat dhe poashtu panelistat e PZAP-it, janë në gjendje që në çdo kohë të mbledhen dhe të vendosin për ankesat e prashtruara nga palet e interesuar. Kjo gjendje gatishmëris duhet të vazhdoj deria sa të bëhet certifikimi i rezultateve të zgjedhjeve.

Gjatë këtij procesi zgjedhor 2014 PZAP-i, ka mbajtur takime dhe kontakte të rregullta me personin kontaktues të Policisë së Kosovës dhe është njoftuar me kohë përrastet e dorëzuara për hetim lidhur meparregullsitë e pretenduara nga ana e subjekteve politike dhe nga palët e interesuara, gjatë gjithë procesit zgjedhor.

Poashtu është bërë përgatitja e formularëve të ankesave në gjuhët zyrtare të Kosovës, si dhe është bërë shtypja e një numrit të mjaftueshëm të këtyre formularëve dhe është bërë shpërndarja tyre nëpër të gjitha Qendrat e Votimit (QV).

Është bërë konfirmimi i kompletimit të procesit të certifikimit të subjekteve politike dhe pritja e ankesave/apelave dhe vendosja e tyre lidhur me certifikimin e subjekteve politike.

Pastaj pranimi i ankesave dhe vendosja e tyre nga ana e panelit për fillimin e fushatës para datës së caktuar për fillimin zyrtar të fushatës zgjedhore, gjatë kohës së heshtjes zgjedhore, për ditën e zgjedhjeve, ankesat që kanë të bëjnë me Qendrën e Numërimit të Rezultateve të Zgjedhjeve – QNR.


Konfirmimin për Komisionin Qendror Zgjedhor për certifikimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve. Paneli Zgjedhor për Ankesat dhe Parashtrësia (PZAP), gjatë procesit të Zgjedhjeve të Parakohshme Parlamentare, ka kryer me sukses funksionet dhe përgjegjësit e tij të përcaktuar me ligj, ku për këtë proces zgjedhor të përmendur më lartë në afatin e paraparë ligjor ka vendosur për 326 ankesa dhe 15 apele, ndërsa për Votuesit Jashtë Kosovës ka vendosur për 9172 ankesa.

Vendosja e të gjitha ankesave nga PZAP-i, në afatet e parapara ligjore i ka mundur, Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), që të bëjë certifikimin e rezultateve të Zgjedhjeve të Parakohshme Parlamentare.

Në tabelën e mëposhtme janë prezantuar anksat e parashtruara nga subjekte të ndryshme politike sipas Komunave për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të dt.08.06.2014.

| Nr. | Komuna | Nr. i ankesave dhe i apeleve |
|----------------|--------------------|------------------------------|
| 1 | Deçan | 4 |
| 2 | Dragash | 0 |
| 3 | Ferizaj | 37 |
| 4 | Fushë Kosovë | 1 |
| 5 | Gjakovë | 3 |
| 6 | Gjilan | 6 |
| 7 | Gllgovc | 2 |
| 8 | Graçanicë | 5 |
| 9 | Han i Elezit | 0 |
| 10 | Istog | 5 |
| 11 | Junik | 0 |
| 12 | Kaçanik | 3 |
| 13 | Kamenicë | 5 |
| 14 | Klinë | 1 |
| 15 | Kllokotë | 1 |
| 16 | Leposaviq | 3 |
| 17 | Lipjan | 1 |
| 18 | Malishevë | 20 |
| 19 | Mamushë | 3 |
| 20 | Mitrovicë | 10 |
| 21 | Mitrovicë e Veriut | 3 |
| 22 | Novobërdë | 0 |
| 23 | Obiliq | 1 |
| 24 | Partesh | 0 |
| 25 | Pejë | 8 |
| 26 | Podujevë | 24 |
| 27 | Prishtinë | 120 |
| 28 | Prizren | 48 |
| 29 | Rahovec | 8 |
| 30 | Shtërpcë | 0 |
| 31 | Shtime | 0 |
| 32 | Skenderaj | 3 |
| 33 | Suharekë | 11 |
| 34 | Viti | 2 |
| 35 | Vushtrri | 2 |
| 36 | Zubin Potok | 0 |
| 37 | Zveçan | 1 |
| Totali: | | 341 |

Paraqitja grafike e ankesave dhe apeleve të parashtruara në PZAP sipas Komunave gjatë procesit zgjedhor të vitit



10. NATYRA E ANKESAVE TË PARAQITURA NË PZAP GJATË PROCESIT TË ZGJEDHJEVE PARAKOHSHME PARLAMENTARETË VITIT 2014

Për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare të vitit 2014, në PZAP janë paraqitur ankesa të natyrave të ndryshme siç janë pasqyruar mëposhtë:

| Nr. | Natyra e ankesave te parashtruara | Numri i ankesave |
|-----|--|------------------|
| 1 | Asistim për të votuar, pa leje nga personat e autorizuar | 3 |
| 2 | Dëmtim posterash, gjatë periudhës së fushatës zgjedhore | 2 |
| 3 | Dërgim i SMS-së, në ditën e heshtjes zgjedhore | 7 |
| 4 | Emri i personave të vdekur gjenden në Listën Përfundimtare të Votuesve (LPV), në ditën e votimit | 3 |
| 5 | Ekzpozimi i logos së subjektit në Vendvotim, në ditën e votimit | 1 |
| 6 | Thyerje e heshtjes zgjedhore nëpërmes Facebook-ut | 2 |
| 7 | Fletëvotimet janë plotësuar nga i njëjti person, janë të fotokopjuara dhe është mbushë kutia e votimit | 6 |
| 8 | Fotografim i Fletëvotimit, në Vendvotim ne ditën e votimit | 1 |
| 9 | Fyerje dhe sharje para selisë së subjektit politik gjatë fushatës zgjedhore | 1 |
| 10 | Gishtrinjet rezultojnë më së shpejtë nga llampa ultravjollcë në ditën e votimit | 2 |
| 11 | Kërcënime, në ditën e votimit | 3 |
| 12 | Pas ofrimit te provave te reja të cilat prova nuk kanë qenë në posedim te panelit në kohën e marrjes së vendimit, palët e interesuara e kanë apeluar vendimin PZAP-it në PZAP për te vendosur edhe njëher për çështjen.. | 3 |
| 13 | Largimi i kandidatit nga lista e subjektit politik, para dites së certifikimit te kandidatëve te subjektit politik | 1 |
| 14 | Manipulim gjatë procesit të votimit, në ditën e votimit | 10 |
| 15 | Manipulim më emrat e kandidatëve në listën e subjektit politik, para ditës së certifikimit te subjekteve politike | 1 |
| 16 | Mbulim posterash, gjatë periudhës së fushatës zgjedhore | 9 |
| 17 | Më pak vota janë publikuar në rezultatin preliminar se sa i posedon, pas ditës së votimit, në fazën e procesit zgjedhor para publikimit te rezultatit përfundimtar, | 12 |
| 18 | Mos emërimi i barabart i kryesuesve të Vendvotimeve, nga KQZ-ja, para ditës së votimit | 7 |
| 19 | Mos lejimi i mbajtjes së tubimit publik gjatë periudhës së fushatës zgjedhore | 1 |
| 20 | Mungesa e votave në Formularin e Rezultateve për Kandidatë (FRK), në ditën e votimit | 63 |
| 21 | Ndalimi i posterave "B2", nga KQZ-ja, gjatë periudhës së fushatës zgjedhore | 1 |
| 22 | Nuk ju ka mundësuar me votue personit me nevoja te veçanta, në ditën e votimit | 1 |
| 23 | Nuk perputhen zarfët me fletëvotimet, në ditën e votimit | 1 |
| 24 | Numërimi i votave jashtë Vendvotimit (VV), në ditën e votimit | 1 |
| 25 | Perdorimi i pasurisë publike dhe shfrytëzimi i pozitës publike më qëllim të përfitimit të votave, gjatë periudhës së fushatës zgjedhore | 4 |

| | | |
|----|--|----|
| 26 | Personat e pa autorizuar kanë qendruar në Qendren e Votimit (QV), në ditën e votimit | 1 |
| 27 | Presion ndaj votuesve për te votuar subjektin e caktuar politik, në ditën e votimit | 3 |
| 28 | Promovim i subjektit politik ne ditën e votimit | 2 |
| 29 | Publikim ne Youtube, në periudhën e heshtjes zgjedhore | 1 |
| 30 | Refuzimi nga KQZ-ja, për ta Regjistruarsubjektinpolitik | 1 |
| 31 | Refuzimi nga KQZ-ja, për ti rinumëruarfletëvotimetepavlefshme | 1 |
| 32 | Shkrim propogadinstik, gjatë periudhës së heshtjes zgjedhore | 1 |
| 33 | Tentim për blerjen e votes, në ditën e votimit | 7 |
| 34 | Thirrje për të votuar në ditën e votimit subjektin e caktuar politik | 2 |
| 35 | Vendosja e billbordeve ne hapësirat e subjekteve tjera politike, gjatë periudhës së fushatës zgjedhore | 1 |
| 36 | Vendosja e flamurave dhe logove në automjete gjatë ditë së votimit | 9 |
| 37 | Vendosja e njoftimeve te subjektit politik ne drunjë dhe në rrethoja të drunjëve, gjatë fushatës zgjedhore | 36 |
| 38 | Vendosja e posterave në dhe mbi rrugë publike, gjatë fushatës zgjedhore | 67 |
| 39 | Vendosja e posterave ne objekte publike, gjatë fushatës zgjedhore | 33 |
| 40 | Vendosja e posterave ne shtylla te ndriqimit publik, gjatë fushatës zgjedhore | 4 |
| 41 | Vendosja e posterit më afër se 100 m nga QV-ja, në ditën e votimit | 6 |
| 42 | Vendosja e posterit ne pronë private pa lejen e pronarit, gjatë fushatës zgjedhore | 2 |
| 43 | Vendosja e posterit në shenjë të Komunikacionit, gjatë fushatës zgjedhore | 3 |
| 44 | Vendosja e tendave te subjektit politik në qytet pa lejen e KKZ-së, gjatë fushatës zgjedhore | 1 |
| 45 | Vota me kusht eshte hedhur ne kutnë e votave te rregullta, në ditën e votimit | 1 |
| 46 | Votim i dyfisht, në ditën e votimit | 1 |
| 47 | Votim pa dokument valid, në ditën e votimit | 1 |
| 48 | Zbulimi i fshtësisë së votës, në ditën e votimit | 3 |
| 49 | Zëvendës drejtori i shkollës fillore është vllau i kandidatit për deputet | 1 |
| 51 | Manipulim të votave me post nga Serbia | 4 |
| 52 | Nuk janë evidentuar saktë votat e qytetarëve të Prishtinës, , në ditën e votimit | 1 |
| 53 | Shpërndarja e Ulëseve në Parlament | 2 |


Siç shihet nga të dhënat e sipërhënuara PZAP-i, gjatë procesit të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare vitit 2014 ka vendosur për 53 lloje të ankesave/apelve me natyra dhe specifika të ndryshme.

Numri ankesave të parashtruara në PZAP për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2014 nga subjekte të ndryshme politike, janë prezantuar ne tabelën e mëposhtme


| Nr | Ankesa dhe Apele te Dorezuara nga SP | Ankesa | Apel e |
|----|---|--------|--------|
| 1 | Aleanca për Ardhemrinë e Kosovës (AAK) | 2 | 0 |
| 2 | Aleanca Kosova e Re (AKR) | 15 | 2 |
| 3 | Centar Demokratske Unije (CDU) | 1 | 1 |
| 4 | BIRN | 2 | 0 |
| 5 | BJL | 2 | 1 |
| 6 | INPO | 1 | 0 |
| 7 | Iniciativa Qytetare Srpska | 0 | 1 |
| 8 | Kandidat per deputet te subjekteve te ndryshme politike | 64 | 0 |
| 9 | Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP) | 7 | 0 |
| 10 | Kosova Turk Adalet partisi (KTAP) | 6 | 2 |
| 11 | Kryesues i Vendvotimit (KVV) | 1 | |
| 12 | Kosovaki Nevi Romani Partia (KNRP) | 1 | 0 |
| 13 | Koalicija Za Gora | 1 | 0 |
| 14 | Lidhja Demokratiek e Kosovës (LDK) | 14 | 0 |
| 15 | Lëvizja Vetëvendosja (LVV) | 124 | 0 |
| 16 | Lista Srpska | 1 | 1 |
| 17 | NISMA për Kosovën | 6 | 1 |
| 18 | Partia Demokraktike e Kosovës (PDK) | 65 | 1 |
| 19 | Progresvina Demokratska Stranka (PDS) | 3 | 3 |
| 20 | Partia Demokratike e Ashkanlive te Kosovës (PDAK) | 1 | 0 |
| 21 | Partia Rome e Bashkuar e Kosoves (PRBK) | 1 | 0 |
| 22 | Qytetar | 7 | 0 |
| 23 | Grupi Tradicional Shqiptar (GTSH) | 1 | 0 |
| 24 | JUG | 0 | 1 |
| 25 | VAKAT | 0 | 1 |

Siç shihet nga tabela e prezantuar më lart 25 subjekte te ndryshme që kanë qenë te involvuara në zgjedhje qofshin ato në garë, si vëzhgues apo neutral kanë parashtruar ankesa në PZAP. Vetë fakti se shumica e subjekteve politike te certifikuara nga KQZ-ja, OJQ dhe Qytetar te ndryshëm që kanë parashtruar ankesa në PZAP të jep te kupton seriozitetin dhe paanshmërinë e marrjes së vendimeve nga ky institucion i pavarur për te vendosur për ankesat dhe apelet gjatë procesit zgjedhor i cili institucion në çdo palë zgjedhje është duke e rritur me hapa te shpejt besimin e mbar opinionit vendor dhe ndërkombëtar.

Paraqitja grafike e ankesave të parashtruar në PZAP për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2014 nga subjekte të ndryshme



Paraqitja grafike e apeleve të parashtruar në PZAP për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2014 nga subjekte të ndryshme



Numri i ankesave dhe i apeleve të parashtruara në PZAP nëpër secilën fazë të procesit zgjedhor për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare të vitit 2014:


Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur ankesat dhe apelet e parashtruara në PZAP, sipas fazave të procesit zgjedhor .


| Nr. | Fazat e procesit zgjedhor | Numri i ankesave | Numri i apeleve |
|---------------|---|------------------|-----------------|
| 1 | Para fillimit të Fushatës Zgjedhore | 3 | 4 |
| 2 | Gjatë periudhës së Fushatës Zgjedhore | 153 | 6 |
| 3 | Për Thyerjen e Heshtjes Zgjedhore | 36 | 0 |
| 4 | Ankesat lidhur me ditën e votimit | 46 | 1 |
| 5 | Ankesat lidhur me Rezultatet Preliminare | 21 | 0 |
| 6 | Ankesat lidhur me administrimin në Qendren e Numerimit të Rezultateve (QNR) | 6 | 0 |
| 7 | Ankesat lidhur me Rezultatet Përfundimtare | 61 | 4 |
| Totali | | 326 | 15 |

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të dhënat të cilat tregojnë për secilën ankesë çfarë vendimi ka marr PZAP-i,

| Nr | Mënyra e marrje së vendimeve: | Ankesa | Apel e |
|----|---|--------|--------|
| 1 | Shpallur Inkompetent | 2 | 0 |
| 2 | Çështje të gjykuara | 8 | 1 |
| 3 | Hudhen si të palejuara | 21 | 1 |
| 4 | Hudhen si të pasafatshme | 10 | 4 |
| 5 | Hudhet e parregullt | 4 | 0 |
| 6 | Miratohen si të bazuara | 66 | 5 |
| 7 | Miratohen për rinumerim | 25 | 0 |
| 8 | Rishikohet vendimi i PZAP-it pas sjelljeve të fakteve të reja nga pala ankuuese | 0 | 1 |
| 9 | Refuzohen si të pabazuara | 169 | 4 |
| 10 | Tërheqje të ankesave nga vetë palët të cilat kanë parashtruar ato ankesa | 20 | 0 |

Paraqitja grafike e ankesave sipas mënyrës së marrjes së vendimeve ndaj tyre për raundin e -I-





11. RASTET E DËRGUARA NË PROKURORINË E SHTETIT

Me rastin e shqyrtimit të ankesave të paraqitura nga palët e interesuara dhe vendosjes së tyre, në Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare të 8 Qershorit 2014, PZAP-i, ka identifikuar disa ankesa në të cilat ka pasur pretendime ankimore me elemente të veprës penale.

Janë gjithsej 34 raste të identifikuara nga PZAP-i, të cilat i ka dorëzuar në Prokurorinë e Shtetit të Republikës së Kosovës.

Natyra e ankesave të dorëzuara në Prokurorinë Shtetërore nga PZAP-i, për procedim të mëtejshum janë si në vijim:

- Përdorimi i pasurisë publike me qëllim të përfitimit të votave,
- Tentim për blerjen e votës,
- Asistim për të votuar pa leje të personave të autorizuar,
- Kërcenim,
- Fshirja e votave në FRK në përmes një lapsi të modifikuar,
- Zbulimi i fshtësisë së votës,
- Presion ndaj votuesve,
- Manipulim me emrat e kandidatëve në list,
- Më pak vota janë publikuar në rezultatin sesa i posedon kandidati,
- Nuk janë regjistruar votat në Formularin e Rezulateve të Kandidatëve (FRK).,
- Nuk janë regjistruar votat në FRK në Vendvotim, prandaj ka edhe mospërputhje me rezultatin përfundimtar,
- Manipulim të votave me post nga Serbia,

12. PADITË E PARAQITURA NDAJ VENDIMEVE TË PZAP-IT NË GJYKATËN SUPREME

Gjatë Zgjedhjeve të Parakohëshme Parlamentare të 8 Qershorit 2014, palët e pa kënaqura me vendimet e PZAP-it, kanë ushtruar të drejtën e tyre ligjore dhe i kanë apeluar vendimet e PZAP-it në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës.

Kundër vendimeve të PZAP-it janë paraqitur 15 ankesa me të cilat janë ankimuar këto vendime në Gjykatën Supreme, prej të cilave 12 padi janë refuzuar nga Gjykata Supreme ndërsa 3 padi janë miratuar dhe çështja është kthyer për rishqyrtim në PZAP.

Natyrat e vendimeve të PZAP-it, të cilat janë ankimuar në Gjykatën Supreme, janë si në vijim:

- Për shkak se iu ka hedhur poshtë apeli si i pasafatshëm, ndaj vendimit të KKZ-së, në Mitrovicën e Veriut për emërimin e anëtarve të KVV-ve,
- Për shkak të ndalesës për pjesëmarrje në zgjedhje të organizuara nga KQZ-ja,
- Për shkak të refuzimit të ankesës së parashtruar kundër procesit të votimit nga votuesit jashtë Kosovës.,
- Për shkak se PZAP-i, iu ka refuzuar ankesën lidhur me shpërndarjen jo të drejtë të ulëseve në parlament,
- Mungesa e votave,
- Manipulim me vota,
- Mospërputhje të votave në mes të FRK dhe publikimit të rezultatit përfundimtar,
- Parregullsi gjatë procesit të votimit,
- Publikim jo real i rezultateve përfundimtare.
- **Për shkak se gjoba e shqiptuar ka qenë mbi 5000 euro**

13. ANKESAT E PRANUARA NË PZAP NGA VOTUESIT JASHTË KOSOVËS

Ankesat nga votuesit jashtë Kosovës ka qenë një sfidëe jashtëzakonshme për institucionin e PZAP-it ngase është hera e dytë që PZAP-i, pranon ankesa nga votuesit jashtë në një sasi-numër mjaft të madhë të ankesave me natyra dhe specifika të ndryshme dhe të cilat kanë një afat ligjor për të vendosur shumë të shkurt sipas LZP-së...

PZAP-i, gjatë procesit zgjedhor 2014, ka pranuar 9172 ankesa nga votuesit jashtë Kosovës, të cilat ankesa janë parashtruar në PZAP, si rezultat i refuzimit të aplikacioneve nga anaKQZ-së, lidhur me mos plotësimin e kriteve të parapara sipas ligjislacionit në fuqi, të cilët me ankesat e tyre kanë kërkuar që të ju jepet e drejta për të votuar në zgjedhjet parlamentare të vitit 2014 siç parashihet në LZP.

Kjo ishte një sfidë për institucionin e PZAP-it nga siç dihet afatet ligjore për të vendosur lidhur me këto ankesa të lartpërmendura është 72 orë, nga momenti i pranimit të tyre në PZAP..

Procesi i Votimit Jashtë Kosovës, pranimi i ankesave dhe dorëzimi/njoftimi i paleve me vendime është bërë me lehtësimin e personelit të Divizionit të Zgjedhjeve të OSBE-së..

Vendosja e 9172 ankesave nga ana panelit, dhe njoftimi i paleve ankuese me 9172 vendime ka qenë një proces shumë i vështirë dhe i ndërlikuar, por që me angazhimin dhe perkushtimin e gjithë personelit të sekretariatit të PZAP-it atij permanent dhe jo permanent si dhe të anetareve të panelit të PZAP-it, me sukses është perballuar dhe është tejkaluar ky proces i votimit të Votuesve Jashtë Kosovës.

PZAP-i, për të vendosur për 9172 ankesa ka organizuar 15 panele, gjë që ka vendosur për të gjitha ankesat brenda afateve parapara ligjore, prej të cilave:

- Për 110 ankesa ka vendosur se janë të parregullta;
- Për 206 ankesa ka vendosur se i plotësojnë kushtet për të votuar dhe i ka miratuar si të bazuara;
- Për 8855 ankesa ka vendosur se nuk kanë dëshmi të mjaftueshme dhe i ka refuzuar si të pabazuara;

14. MEMORANDUMI I BASHKËPUNIMIT

në mes te

Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), Këshillit Prokuroria të Kosovës (KPK), Policisë së Kosovës (PK), Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) dhe Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)

Duke u nisur nga parregullsitë e ndodhura gjatë proceseve të kaluara zgjedhore siç ishin Zgjedhjet Lokale të vitit 2009/2010, Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare të mbajtura në vitin 2010/2011, si dhe duke e parë efektin shumë pozitiv që ka pasur Memorandumi i Bashkëpunimit në mes të Institucioneve të Republikës së Kosovës përgjegjëse për mbarëvajtjen e zgjedhjeve në Zgjedhjet Lokale të vitit 2013, me qëllim të parandalimit të parregullsive që mund të ndodhin në Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare që do të mbahen më 8 qershor 2014 nën udhëheqjen e Prokurorit të Shtetit, me pëlqimin institucioneve bartëse të përgjegjësisë së procesit zgjedhor dhe të atyre që në mënyrë indirekte janë të lidhura me përgjegjësi ligjore lidhur me këtë proces me datën 16.05.2014, është miratuar Memorandumi i Mirëkuptimit (MiM) në mes të KGJK-së, KPK-së, PK-së, KQZ-së dhe PZAP-it, i cili MiM është hartuar dhe miratuar në pajtim me Ligjet e aplikueshme që rregullojnë mandatin e Institucioneve të lartpërmendura.

Këto Institucione në bazë të nenit 8 pika 1 dhe pika e 2 e këtij MiM, obligohen që të harmonizojnë dhe koordinojnë planet e veprimit për të gjitha aktivitetet për procesin Zgjedhor të Zgjedhjeve të Parakohshme Parlamentare që do të mbahen më 8 qershor 2014.

Plani i veprimit për Zgjedhjet e parakohshme Parlamentare të 8 qershorit 2014, do të përfshijë aktivitete dhe veprimet procedurale si dhe çështjet tjera që ndërlidhen në mes të PZAP-it dhe këtyre Institucioneve që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor nga shpallja zyrtare e Zgjedhjeve të Parakohshme Parlamentare deri në përfundimin e këtyre rasteve nga Gjykatat.

Plani i veprimit ka për qëllim që të gjitha aktivitetet dhe veprimet që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor nga Institucionet nënshkruese të këtij MiM të koordinohen dhe harmonizohen në at mënyrë që procesi zgjedhor i Zgjedhjeve të Parakohshme Parlamentare që do të mbahen më 8 qershor 2014, të jetë sa më i suksesshëm.

Edhe në të kaluarën të gjitha këto institucione në mes vete kanë pasur bashkëpunim të mirë me çka kanë arritur që të gjitha çështjet, rastet të procedojnë në mënyrën sa më të mirë të mundshme, por ky Memorandum dhe planet e veprimit që do të hartohen dhe miratohen nga këto institucione palë në këtë memorandum do të lehtësoj bashkëpunim dhe do të mundësoj koordinimin e tyre më të mirë në mënyrë që procesi zgjedhor i zgjedhjeve të 8 qershorit 2014 të kalojë sa më pak parregullsi dhe të jetë i suksesshëm.

Koordinimi i aktiviteteve në mes të PZAP-i dhe KQZ-së

PZAP-i, koordinon dhe harmonizon aktivitetet me KQZ-në, gjatë gjithë procesit zgjedhor prej shpalljes zyrtare të zgjedhjeve e deri të shpallja e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve:

- **Regjistrimi i Partive Politike dhe Certifikimin e Subjekteve Politike**, (Partive Politike, Iniciativave Qytetare, Kandidateve të Pavarur). Subjektet Politike për të marrë pjesë në zgjedhje fillimisht duhet të kandidojnë (aplikojnë) për tu certifikuar në KQZ. KQZ-ja – ZRPPC-ja, me pranimin e aplikacionit nga subjekti politik, kërkon nga PZAP-i, konfirmimin me shkrim për subjektin politik që ka aplikuar se a i ka paguar të gjitha gjordat në lidhje me cilat do zgjedhje të më

parme dhe te konfirmoj se nuk ka borxhe tjera te papaguara. KQZ-ja – ZRPPC-ja, kërkon nga PZAP-i, konfirmimin me shkrim për emrat dhe mbiemrat e personave te ndalur me vendime të PZAP-it, qe të janë kandidatë apo pjesë përbërëse e stafit administrativ në zgjedhje që menaxhohen nga KQZ-ja dhe PZAP-i është i obliguar që ta përmbush këtë detyrë.

- **Akreditimi i Vëzhguesve te zgjedhjeve**, Çdo individ ose organizatë qe ka aplikuar për certifikim për vëzhgim te procesit zgjedhor e qe i është mohuar akreditimi nga KQZ-ja mund te parashtroj apel ne PZAP dhe PZAP-i është i obliguar të vendos për apelin brenda 72 orëve.
- **Votimi Jashtë Kosovës - Konfirmimi dhe Procesi i Ankesave**, KQZ-ja njofton kandidate qe kanë aplikuar për votim jashtë Kosovës, nëse aplikimi i tij/saj është pranuar ose refuzuar. Ndaj vendimit te KQZ-së për refuzim te aplikimit kandidati qe ka aplikuar ka te drejtë te bëjë ankesë ne PZAP.
- **Dorëzimi i Formularëve te Ankesave**: PZAP-i kërkon ndihmën e KQZ-së që gjatë shpërndarjes se materialit për zgjedhje nga ana e KQZ-së neper Qendra te Votimit (QV) dhe Vendvotime (VV) te shpërndaj edhe Formularët e Ankesave ne mënyrë që votuesit te kenë mundësi te paraqesin ankesat e tyre lidhur me parregullsitë qe mund te ndodhin gjatë ditës se votimit.
- **Qendra e Numrit dhe Rezultateve** – QNR, PZAP-i bashkëpunon me QNR ne lidhje me ankesat qe kanë te bëjnë me administrimin e numërimit ne QNR.
- **Certifikimi i rezultateve përfundimtare te zgjedhjeve**. PZAP-i bashkëpunon me KQZ-ne lidhur me certifikimin e zgjedhjeve. Pas përfundimit te procedurave ankimore ne Vendvotime dhe ne Qendrat e Numërimit nga PZAP-i dhe Gjykata Supreme, KQZ-ja certifikon rezultatet përfundimtare te Zgjedhjeve te Parakohshme Parlamentare te 8 qershorit 2014.
- **Ankesa qe kanë te bëjnë me mos deklarimin e raportit financiare te fushatës zgjedhore për raundin e pare dhe te dyte**. Nëse një subjekt politik nuk e dorëzon Raportin e Publikimit Financiar te fushatës deri ne afatin përfundimtarë ose, dorëzon raport jo te plote dhe te pasaktë, ZRPPC, paraqet ankesë në PZAP, 45 dite pas ditës se Zgjedhjeve te Parakohshme Parlamentare te 8 qershorit 2014.
- **Koordinimi dhe bashkëpunimi lidhur me shkatërrimin e materialit zgjedhor sipas afateve te përcaktuara me ligj**. KQZ-ja me një vendim pas certifikimit zyrtar te rezultatit te zgjedhjeve shkatërron materialet e zgjedhjeve brenda 60 ditëve, përveç nëse udhëzohet ndryshe nga PZAP-i.

Koordinimi i aktiviteteve ne mes te PZAP-i dhe Policisë së Kosovës (PK)

- **Bashkëpunimi i PZAP-it me Policinë e Kosovës**. PZAP-i kërkon ndihme e Policisë së Kosovës gjatë gjithë procesit zgjedhor e ne veçanti gjate fushatës zgjedhore dhe ditës se votimit për hetimin e rasteve te paraqitura përmes ankesave nga individë dhe subjekte politike për parregullsitë qe pretendohet se kane ndodhur gjate procesit zgjedhor.
- **Caktimi i personave kontaktues PZAP-i - Policia e Kosovës**. Me qellim te lehtësimit dhe koordinimit me te mirë te punës ne mes te PZAP-it dhe PK nga te dy Institucionet duhet te caktohen nga një ose me shume personat kontaktues te cilët do te bashkëpunojë dhe koordinojnë punën lidhur me rastet e ankesave qe kane te bëjnë me elemente për hetim ne rast te kanosje, kërcënimeve pengimit te aktiviteteve te ndryshme zgjedhore, pengimit te tubimeve elektorale dhe parregullsi tjera gjatë ditës se votimit etj.

- **Dërgimi i ankesave me elemente te veprës penale nga PZAP-i ne Policinë e Kosovës dhe kthimi i raportit lidhur me ankesat ne PZAP nga ana e Policisë.** Personi kontaktues i PZAP-it do ti adreson përmes postes elektronike te gjitha ankesat dhe shkresat e lendes te skanuara te personat kontaktues te Policisë së Kosovës te cilët obligohen qe këto ankesa bashke me materialet tjera përcjellëse ti pranojnë dhe t'i procedon për kompetence te mëtejme për shqyrtimin e tyre nga ana e Zyrtareve te Njësive te Departamenteve përgjegjëse te Policisë së Kosovës. Policia e Kosovës pas shqyrtimit te rasteve obligohet që PZAP-in ta informoj përmes personit kontaktues me një raport te shkruar lidhur me progresin e hetimeve për pretendimet ankimore.

Koordinimi i aktiviteteve ne mes te PZAP-i dhe Këshillit Prokuroria te Kosovës (KPK)

- **Dorëzimi procedimi i rasteve me elemente te veprës penale nga PZAP-i ne Prokurorin e Shtetit.** PZAP-i obligohet që te procedoj në KPK, respektivisht ne Prokurorin e Shtetit të gjitha ankesat se bashku me shkresat përcjellëse te lendes nëse PZAP-i konsideron se ka elemente te Veprës Penale. Sipas LZP-së, vendimi për caktimi i një gjobe apo ndonjë sanksione tjetër nga PZAP-i, është pa paragjykim ndaj ndonjë sanksioni penal qe mund te pasoj. PZAP-i gjate shqyrtimit te ankesave ne baze te pretendimeve ankimore dhe shkresave te lendes mund te konstatoj se ne ato ankesa ka elemente te përgjegjesisë individuale që individ te caktuar kane abuzuar ne mënyra te ndryshme gjatë procesit zgjedhor e që ato vepra penale janë të ndëshkueshme me Kodin e Ri Penal të Republikës së Kosovës. PZAP-i te gjitha rastet e përmendura me lartë i dërgon në KPK jo me vone se 45 dite pas certifikimit te rezultateve përfundimtare te zgjedhjeve për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare te 8 qershorit 2014. PZAP-i obligohet që deri ne përfundimin e plote te shqyrtimit te këtyre rasteve nga Prokuroria ti ofroj te gjitha materialet qe Prokuroria kërkon për këto dhe raste tjera lidhur me këtë proces zgjedhor. Do te ishte me interes qe Prokuroria e Shtetit t'i mbaje te informuara institucionet nënshkruese te këtij MiM me rezultatet e hetimit për te gjitha rastet e dorëzuara ne Prokurori për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare te 8 qershorit 2014.

Koordinimi i aktiviteteve ne mes te PZAP-i dhe Këshillit Gjyqësor te Kosovës (KGJK-së)

- PZAP-i, obligohet qe Gjykatës Supreme ti ofroj te gjitha shkresat e lendes për vendosje ne shkallë te dyte lidhur me Apelimet qe palët parashtrajnë ne këtë Gjykate si dhe obligohet qe Gjykatave kompetente ti ofroj prova te nevojshme materiale nëse këto gjykata i kërkojnë nga PZAP-i për vendosjen e lendeve te dorëzuara ne Gjykata lidhur me kallëzimet penale qe ka ngritur Prokuroria e Shtetit. Do te ishte me interes qe KGJK-ja t'i mbaje te informuara institucionet nënshkruese te këtij MiM me dënimet e shqiptuara ndaj kryerësve te veprave penale për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare te 8 qershorit 2014.

Akteret e këtij MiM, obligohen te zbatojnë aktivitetet dhe veprimet e përfshira ne këtë MiM, por jo ne mënyrë te kufizuar për arsye se mund te dalin aktivitetet tjera shtese e qe janë te detyrueshme për ti zbatuar.

